



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo Ministria e Zhvillimit Ekonomik / Ministarstvo Ekonomskog Razvoja Ministry of Economic Development			
Nr. Org. Org. Jedin. Org Unit	0113	Nr. Prot. Br. Prot Prot No.	568
Nr. i faqeve Broj stranica No. pages:	-	Data Datum Date:	04-03-15
PRISHTINE/A			

**N.Sh."Univerzum Audit"**

**PASQYRAT FINANCIARE DHE  
RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR  
PËR PERIUDHËN 01.01.2014- 31.12.2014  
N.H. IBER LEPENC SH.A.**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA  
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo  
Ministria e Zhvillimit Ekonomik / Ministarstvo Ekonomskog Razvoja  
Ministry of Economic Development

Nr. i fazeve / Broj stranica / No. pages: /

Nr. Prot. / Br. Prot. / Prot. No.: /

Data / Datum / Date: /

PRISHTINË/A



**Përmbajtja**

1.	Raporti i auditorit të pavarur .....	4
2.	Informatatë përgjithshme rreth kompanisë.....	6
3.	Pasqyrat financiare.....	7
4.	Pasqyrat e politikave të rëndësishme të kontabilitetit.....	11



**Shkurtesat e përdorura:**

**SNA-** Standardet Ndërkombëtare të Auditimit

**SNK-** Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit

**SKK-** Standardet Kosovare të Kontabilitetit

**ATK-** Administrata Tatimore e Kosovës

## RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

### PËR BORDIN E DREJTORËVE TË NH IBËR LEPENC SH.A.

Ne kemi audituar Pasqyrat Financiare (Pasqyrën e pozicionit financiar; Pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse; Pasqyrën e flukseve monetare, Pasqyrën e ndërrimeve në ekuitet si dhe kemi pasur në dispozicion edhe Shpalosjet e Pasqyrave ) të NH Ibër Lepenc SH.A. për periudhën kalendarike 01.01.2014-31.12.2014 . Këto Pasqyra Financiare janë përgjegjësi e Menaxhmentit të Shoqërisë. Përgjegjësi e jona është, që bazuar në auditimin tonë të shprehim një opinion lidhur me këto Pasqyra Financiare.

#### *Përgjegjësia e menaxhmentit për Pasqyrat Financiare*

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe SKK. Kjo përgjegjësi përfshinë: dizajnimin, implementimin dhe mbajtjen e kontrollit të brendshëm relevant për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare që janë të lira nga gabimet materiale, qoftë nga mashtrimi apo gabimi; përzgjedhjen dhe aplikimin e politikave të duhura të kontabilitetit dhe bërjen e vlerësimeve të kontabilitetit që janë të arsyeshme për rrethanat.

#### *Përgjegjësia e auditorit*

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në kryerjen e auditimit. Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne t'i përmbahemi kërkesave etike dhe planifikojmë e kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare janë të lira nga ndonjë gabim material. Auditimi përfshinë procedurat e kryerjes për të marrë dëshmi të auditimit lidhur me vlerat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen në gjykimin e auditorit, duke përfshirë vlerësimin e rrezeve të gabimeve materiale të pasqyrave financiare, qoftë nga ndonjë mashtrim ose gabim. Auditimi gjithashtu përfshinë vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël të bëra nga Menaxhmenti, gjithashtu edhe prezantimin e përgjithshëm të pasqyrave financiare.

Ne besojmë që dëshmitë e auditimit që ne kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për të siguruar bazën për opinionin tonë të auditimit.



### *Opinion*

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të Kompanisë paraqesin drejtë pozitën financiare të NH Ibër Lepenc SH.A në Prishtinë në gjithë aspektin material, gjithashtu prezentojnë drejtë rezultatet e operacioneve, dhe rrjedhën e parasë së gatshme për vitin kalendarik që përfundonë me 31 Dhjetor 2014, dhe janë në harmoni me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe SNA.

### *Theksim i çështjes*

Duke mos e kualifikuar mendimin tonë, ne tërheqim vëmendjen për çështjen si në vijim:

Sikur në vitet paraprake po ashtu edhe në këtë periudhë, bazuar në Rregulloren e Tatimit në Fitim, për qëllime të tatimit kompania përdorë koston historike të mjeteve themelore si bazë për llogaritjen e shpenzimeve të zhvlerësimit të mjeteve themelore përderisa për kontabilitetin e Ndërmarrjes duke u bazuar në SNK, si bazë për llogaritjen e shpenzimeve të zhvlerësimit merret baza e rivlersuar e aseteve si dhe shkallët e zhvlerësimit të përcaktuara nga ana e rivlersuesve. Si rezultat i kësaj ndodhin diferencat në shpenzimet e zhvlerësimit të cilat diferenca rregullohen në Deklaratat vjetore të Tatimit në të Ardhura të Korporatave.

Për faktin se ndërmarrja disa vite me radhë operon me humbje pas zhvlerësimit, në pamundësi të gjenerimit të fitimit të tatueshëm Mbështetur në SNK-12-Tatimet mbi të ardhurat, ndërmarrja nuk ka njohur në pasqyrat e veta ndonjë pasuri apo detyrim të shtyrë tatimor për vitin 2014.

N.Sh. "UNIVERZUM-AUDIT"

Prishtinë

Shkurt, 2015



A handwritten signature in blue ink is written over a blue circular stamp. The stamp contains the text "UNIVERZUM-AUDIT" and "PRISHTINE" around the perimeter, with "NDERMARRJA SHKURT" at the top.



## TË PËRGJITHSHME

NH Ibër Lepenc Sh.a. ("Ndërmarrja") është shoqëri aksionare e inkuorporuar në Kosovë dhe e regjistruar sipas Regjistrimit të Bizneseve me numër regjistrimi 70465157 me datë 31 Dhjetor 2007. Adresa e zyrës së saj kryesore të regjistruar është: Sheshi "Bill Klinton" Nr. 13, Prishtinë, Kosovë. Ndërmarrja është konstituuar në vitin 1986 si Ndërmarrje Shoqërore me qëllim të operimit dhe mirëmbajtjes të infrastrukturës së sistemit shumë funksional për furnizim me ujë. Më vonë është transformuar në Ndërmarrje Publike nga Misioni i UNMIK-ut. Në vitin 2007 me përfundimin e korporatizimit ndërmarrja ka marrë statusin e shoqërisë aksionare dhe është kategorizuar si ndërmarrje publike qendrore. Ndërmarrja NH Ibër Lepenc Sh.a. në përputhje me ligjin numër 03/L-087 mbi Ligjin mbi Ndërmarrjet Publike dhe Ligjit Nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare, ka marrë statusin e shoqërisë aksionare dhe është kategorizuar si ndërmarrje publike qendrore, aksionar i vetëm i së cilës është Qeveria e Republikës së Kosovës. Kapitali fillestar i regjistruar i ndërmarrjes kap shumë prej 25 mijë euro. Aseti kryesor i ndërmarrjes është Diga në Ujman e cila mundëson akumulimin e ujit i cili përdoret për prodhimin e energjisë elektrike, furnizimin e industrisë me ujë të papërpunuar për ftohje për KEK – Termocentralet "Kosova A" dhe "Kosova B" si dhe Ferronikeli, ujësjellësit regional në Mitrovicë dhe Prishtinë dhe furnizimin e ko-operantëve të bujqësisë me ujë për ujitje. Akumulimi në digën e Ujmanit ka kapacitet prej 375 milion m<sup>3</sup> ujë. Fillimisht uji nga diga përdoret për prodhimin e energjisë elektrike përmes Hidrocentralit me kapacitet të instaluar 35 MW duke shpenzuar mesatarisht 4 m<sup>3</sup> për prodhimin e 1 kWh energji elektrike, pastaj uji akumulohet në basenin kompenzues në Pridvoricë i cili ka kapacitet prej 480.000 m<sup>3</sup>. Nga baseni kompenzues i Pridvoricës uji pjesërisht shkarkohet në lum, me qëllim të ruajtjes të minimumit biologjik dhe sasia tjetër në kanalin kryesor me kapacitet fillestar prej 22 m<sup>3</sup>/sec, në gjatësi prej 50 km, nga ku furnizohen të gjithë shfrytëzuesit si industria, ujësjellësit dhe bujqësia. Gjatësia e përgjithshme e kanaleve të hapura është 146,6 km ndërsa gjatësia e rrjetit nëntokësor të gypave është 766 km. Infrastruktura e ndërmarrjes shtrihet në pjesën veriore dhe qendrore të Kosovës ku përfshinë këto komuna: Zubin Potok, Mitrovicë, Vushtrri, Kastriot, Fushë Kosovë, Prishtinë dhe Drenas. Ndërmarrja NH Ibër Lepenc Sh.a. është e organizuar në dy njësi afariste:

1. Njësia afariste "Uji & Centrali elektrik",
2. Njësia afariste "Ujitja",



**NH IBËR LEPENC SH.A.**  
**Pasqyra e Pozicionit Financiar**  
**Për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2014**

MJETET	Note	Periudha raport.	Per.Mëparshme
		2014	2013
Mjetet Qarkulluese		3,185,196	3,680,940
Arka dhe Xhirologaria	4	965,848	1,345,729
Llogaritë e Arketueshme	5	970,011	1,068,543
Kërkesat tjera afat shkurte	5	16,029	20,945
Shpenz. e parapaguara dhe të hyrat e akruale	6	6,952	3,985
Stoqet		1,226,356	1,241,738
Avanset e paguara Furnitorëve			
Mjetet Fikse	7	130,852,099	134,601,638
Kërkesat afat gjate			
Depozitet, kaparet			
Kërkesat ndaj ndërmarjeve në falimentim			
Akcionet dhe pjesëmarjet			
Inventari, Paimet dhe Makinat		2,161,420	2,360,559
Ndërtesat		128,690,679	132,241,079
Toka			
<b>Gjithsejtë MJETET</b>		<b>134,037,295</b>	<b>138,282,578</b>
<b>DETYRIMET</b>			
Detyrimet afat shkurtra	8	599,012	730,890
Llogaritë e pagueshme		494,123	466,675
Tatimi në të Ardhurën, i pagueshëm.		35,113	29,136
Shpenzimet akruale dhe Avanset e marruna			
Huatë afat shkurtra			
Detyrimet tjera afat shkurtra		69,776	235,079
Detyrimet afat gjate		479,434	485,156
Te hyrat e shtyra		479,434	485,156
Huatë afat gjate			
<b>Gjithsejtë DETYRIMET</b>		<b>1,078,446</b>	<b>1,216,046</b>
Kapitali		132,958,849	137,066,532
Akcionet		25,000	25,000
Vlera historike e Aseteve te Ndërmarrjes		162,419,111	162,419,111
Ndihmat, Grantet, Dhuratat- e kapitalizuara			
Fitimet ( Rezultatet ) e bartura		(25,377,579)	(21,477,523)
Fitimi i periudhës raportuese		(4,107,683)	(3,900,056)
<b>Gjithsejtë Detyrimet dhe Kapitali</b>		<b>134,037,295</b>	<b>138,282,578</b>

**Konfirmoi/Demë Abazi**  
**Pozita/U.D. Kryeshef Ekzekutiv**

Data/31.01.2015



**NH IBËR LEPENC SH.A.**  
**Pasqyra e të Ardhurave Gjithpërfshirëse**  
**Për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2014**

		<u>Periudha raport.</u>	<u>P.Mëparshme</u>
		2014	2013
Shitjet e faturuara nga veprimtaria themelore	10	4,142,873	4,057,894
Të Hyrat tjera	11	41,283	35,191
<b>Gjithsejtë të Hyrat</b>		<b>4,184,156</b>	<b>4,093,085</b>
Shpenzimet direkte te materialit të prodhimeve te shitura			
Fitimi Bruto	12	4,184,156	4,093,085
Shpenzimet Operative			
Pagat bruto		2,800,167	2,698,938
Mirëmbajtja dhe Riparimet		33,348	44,112
Shpenzimet Administrative		91,059	68,874
Rryma elektrike / Elektriciteti		345,807	276,066
Shpenzimet e Derivateve		62,572	59,190
Shpenzimet për shërbime		50,763	55,830
Mallra dhe material		104,181	75,106
Shlyerja e borxheve të këqija			
Material hargjues dhe taksa		184,443	186,807
<b>Gjithsejtë Shpenzimet Operative</b>		<b>3,672,340</b>	<b>3,464,923</b>
Fitimi Operativ para zhvleftësimit të mjeteve		511,816	628,162
Zhvleftësimi i Mjeteve të punës			
Inventari, Paimet, Makinat (edhe ato të marra në shfrytëzim)		222,434	216,540
Ndërtesat dhe Toka		4,401,973	4,381,034
Gjithsejtë Zhvleftësimi i mjeteve		4,624,407	4,597,574
Fitimi Operative pas zhvleftësimit të mjeteve		(4,112,591)	(3,969,412)
Të Hyrat dhe të Dalurat Financiare			
Të Hyrat Financiare	11	5,320	76,796
Të Dalurat financiare		412	7,440
<b>Gjithsejtë të Hyrat Financiare</b>		<b>4,908</b>	<b>69,356</b>
E Ardhura para Tatimit dhe Rezervave të pa tatimuara		(4,107,683)	(3,900,056)
Tatimi në fitim			
<b>Fitimi ( Humbja )</b>		<b>(4,107,683)</b>	<b>(3,900,056)</b>
Nr. mesatar i të punësuarve		289	296

Konfirmoi : Demë Abazi

Pozita : U.D.Kryeshefi Ekzekutiv

Data: 31.01.2015





**NH IBËR LEPENC SH.A.**  
**Pasqyra e flukseve monetare**  
**Për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2014**

	Periudha raport. 2014	Periudha raport. 2013
<b>A. Rrjedha e parasë së gatshme nga aktivitetet operative</b>		
Inkasimet nga aktivitetet operative	4,879,611	4,710,342
Inkasimet e tjera	76,977	49,645
Pagesat ndaj furnitorëve	(1,190,543)	(776,819)
Pagesat për pagat e punëtorëve	(2,898,822)	(2,686,686)
Pagesat e tjera (TVSH, avanset, shërbime dhe konsulencë, dëmet)	(593,839)	(493,042)
<b>Gjithshejt rrjedha e parasë së gatshme nga aktivitetet operative</b>	<b>273,384</b>	<b>803,440</b>
<b>B. Rrjedha e parasë së gatshme nga aktivitetet investuese</b>		
Investimet kapitale	(654,285)	(1,131,426)
Inkasimet nga shitja e mjeteve themelore		
<b>Gjithshejt rrjedha e parasë së gatshme nga aktivitetet investuese</b>	<b>(654,285)</b>	<b>(1,131,426)</b>
<b>C. Rrjedha e parasë së gatshme nga aktivitetet financiare</b>		
Inkasimet nga interesi ne depozita dhe hua marrjet tjera	1,020	113,835
Pagesa e tatimit ne interes		(11,384)
<b>Gjithshejt rrjedha e parasë së gatshme nga aktivitetet financiare</b>	<b>1,020</b>	<b>102,451</b>
Ndryshimet në mjetet qarkulluese	(379,881)	(225,535)
<b>Paraja e gatshme në fillim të vitit</b>	<b>1,345,729</b>	<b>1,571,264</b>
<b>Paraja e gatshme në fund të vitit</b>	<b>965,848</b>	<b>1,345,729</b>

Konfirmoi / Demë Abazi  
 Pozita/U.D.Kryeshef Ekzekutiv

Data: 31.01.2015





**NH IBËR LEPENC SH.A.**  
**PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKUITET**  
**Për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2014**

VITI	KAPITALI AKSIONAR	KAPITALI	REZERVA E RIVLERËSUAR	FITIMI / HUMBJA	NETO EKUITETI
Me 31.12.2005		113,454,835		(18,619,565)	94,835,270
Fitimi (Humbja) - 2006				(5,012,344)	(5,012,344)
Me 31.12.2006		113,454,835		(23,631,909)	89,822,926
Korrigjimet sipas PC&A me 01.01.2007		(113,454,835)		23,631,909	(89,822,926)
Regjistrimi sipas PC&A me 01.01.2007	25,000		162,419,111		162,444,111
Fitimi (Humbja) - 2007				(3,802,350)	
Me 31.12.2007	25,000		162,419,111	(3,802,350)	158,641,761
Fitimi (Humbja) - 2008	25,000			(3,521,356)	(3,521,356)
Me 31.12.2008			162,419,111	(7,323,706)	155,120,405
Korr. per shp. e pagave				(116,403)	(116,403)
Me 31.12.2008				(7,440,109)	155,004,002
Fitimi (Humbja) - 2009				(3,544,307)	(3,544,307)
Me 31.12.2009	25,000		162,419,111	(10,984,416)	151,459,695
Fitimi (Humbja) - 2010				(2,333,783)	(2,333,783)
Me 31.12.2010	25,000		162,419,111	(13,318,199)	149,125,912
Fitimi (Humbja) - 2011				(3,989,516)	(3,989,516)
Me 31.12.2011	25,000		162,419,111	(17,307,715)	145,136,396
Fitimi (Humbja) - 2012				(4,169,808)	(4,169,808)
Me 31.12.2012	25,000		162,419,111	(21,477,523)	140,966,588
Fitimi (Humbja) - 2013				(3,900,056)	(3,900,056)
Me 31.12.2013	25,000		162,419,111	(25,377,579)	137,066,532
Fitimi(humbja) -2014				(4,107,683)	(4,107,683)
Me 31.12.2014	25,000		162,419,111	(29,485,262)	132,958,849

**Konfirmoi/Demë Abazi**  
**Pozita/U.D.Kryeshef Ekzekutiv**

Data: 31.01.2015



## **BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE**

### **2.1 Deklarata e përputhshmërisë**

Këto pasqyrat financiare janë të përgatitura në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe Interpretimet (ndryshe IFRS) të botuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (IASB) siç janë adaptuar nga Unioni Evropian ("IFRS të adaptuara").

### **2.2 Baza e përgatitjes**

Këto pasqyra financiare janë përgatitur sipas parimit të kostos historike përveç rastit të rivlerësimit të aseteve fikse.

Politikat e kontabilitetit janë konsistente, pra politikat e njëjta kontabël që janë miratuar më parë parë aplikohen në mënyrë të njëjtë nga një periudhë në tjetrën. Pasqyrat financiare janë përgatitur në baza krahasuese duke i paraqitur saldot e zërave për vitin vijues dhe vitin e kaluar.

### **2.3 Parimi i vazhdueshmërisë**

Këto pasqyra financiare janë përgatitur duke u bazuar në parimin e vazhdueshmërisë. Siç tregohet në pasqyrat financiare, Ndërmarrja ka regjistruar një rezultat neto negativ për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2014 në vlerë prej 4,107,683 Euro që rezultoi me rritjen e humbjeve të akumuluarra më 31 Dhjetor 2013 në vlerë prej 25,377,579 Euro në 29,485,262 Euro më 31 Dhjetor 2014.

Ndërmarrja ka të aprovuar planin trevjeçar 2012-2015 ku janë paraqitur synimet dhe objektivat e ndërmarrjes në zgjerimin e veprimtarisë, rritjen e aseteve dhe shfrytëzimin më të madh të kapaciteteve që do të siguronin edhe ngritjen e të hyrave gjatë tri viteve të ardhshme.

### **2.4 Transaksionet në valutë të huaj**

Transaksionet në valutë të huaj përveç Euros regjistrohen sipas kursit të këmbimit në fuqi në datën e transaksionit. Ndryshimet e këmbimit si rezultat i zgjidhjes së transaksioneve në valutë të huaj përveç Euros përfshihen në pasqyrën e të ardhurave duke përdorur kursin e këmbimit i cili është në fuqi në atë datë. Asetet dhe detyrimet monetare të shndërruara në valuta tjera përveç Euros kthehen në Euro sipas kursit mesatar të këmbimit në treg në datën e bilancit të gjendjes. Fitimet dhe humbjet në valuta të huaja që ndodhin për shkak të këmbimit të aseteve dhe detyrimeve reflektohen në pasqyrën e të ardhurave si diferencë ndërmjet fitimeve dhe humbjeve për shkak të shndërrimit të kursit të këmbimit.



## 2.5 Prona, impiantet dhe pajisjet

Artikujt e pronës, impianteve dhe pajisjeve me 1 Janar 2008 deklarohen sipas kostos së vlerësuar minus zhvlerësimi i akumuluar dhe dëmtimi, përderisa artikujt e pronës, impianteve dhe pajisjeve të blera pas 1 Janarit 2008 deklarohen sipas kostos minus zhvlerësimi i akumuluar dhe dëmtimi nëse ka pas. Kostoja e vlerësuar paraqet vlerat fillestare të aseteve të vlerësuara nga Ndërmarrja me ndihmën e një konsulenti të pavarur (PC&A) më 31 Dhjetor 2007. Kostot pasuese janë të përfshira në vlerën bartëse të aseteve apo njihen si një aset i veçantë, sipas nevojës, vetëm kur besohet që përfitime ekonomike në të ardhmen që lidhen me asetin do të rrjedhin për Ndërmarrjen dhe kostoja e asetit mund të matet me besueshmëri. Zhvlerësimi i aseteve llogaritet duke përdorur metodën lineare për të shpërndarë koston e tyre ose shumën e rivlerësuar në vlerën e tyre të mbetur gjatë kohëzgjatjes së vlerësuar të përdorimit siç vijon: Ndërtesat dhe objektet tjera 50 - 100 vite Makineritë e rënda 10 – 50 vite Pajisjet dhe inventari tjetër 5 - 10 vite Vlera e mbetur e aseteve dhe koha e përdorimit rishikohet, dhe korrigjohet nëse është nevoja, në secilën datë të bilancit të gjendjes. Vlera e bartur e asetit shlyhet menjëherë në shumën e rikuperueshme nëse vlera e bartur e asetit është më e madhe se shumata e vlerësuar e rikuperueshme. Fitimet dhe humbjet nga largimi nga përdorimi përcaktohen duke krahasuar të ardhurat me vlerën e bartur. Këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave. Ndërmarrja me politikën e pranuar të kontabilitetit lidhur me rivlerësimin dhe dëmtimin e mjeteve jo financiare kërkon në çdo datë të bilancit të gjendjes që zërat e pronës, impianteve dhe pajisjeve të rivlerësohen dhe rishikohen për dëmtim, kurdoherë që ngjarjet ose ndryshimet në rrethanat tregojnë që vlera bartëse e një mjeti nuk mund të jetë e rikuperueshme. Siç është shpalosur në shënimin 4 të pasqyrave financiare shoqëruese, më 31 Dhjetor 2014 vlera neto bartëse e pronës, impianteve dhe pajisjeve është në vlerë prej 130,852,099 EUR.



## **POLITIKAT E RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT DHE SHPALOSJET (VAZHDIM)**

### **2.6 Asetet e paprekshme**

Asetet e paprekshme përbëhen nga softuerët e licencuar për kompjuterë. Këto fillimisht deklarohen sipas kostos së tyre dhe më pas sipas kostos minus amortizimi i akumuluar dhe humbjet e akumuluar të dëmtimeve, nëse ka pasur. Amortizimi regjistrohet kur këto asete janë në dispozicion për përdorim duke përdorur metodën lineare përderisa kostoja e një asemi të paprekshëm shlyhet përgjatë kohëzgjatjes së vlerësuar të përdorimit.

### **2.7 Asetet dhe detyrimet financiare**

Asetet dhe detyrimet financiare që ndodhen në bilanc të gjendjes përfshijnë paratë e gatshme dhe ekuivalentët e parasë së gatshme, llogaritë e arkëtueshme dhe detyrimet. Politikat e kontabilitetit mbi njohjen dhe matjen e këtyre zërave janë të shpalosura në politikat përkatëse të kontabilitetit që janë të përfshira në këtë shënim. Ndërmarrja i klasifikon instrumentet e saja financiare si asete, detyrime apo ekuitet në përputhje me substancën e marrëveshjes së ndërlidhur kontraktuale. Interesat, fitimet dhe humbjet që lidhen me instrumentet financiare të klasifikuara si asete ose detyrime raportohen si të hyra ose shpenzime, respektivisht Instrumentet financiare thyhen kur Ndërmarrja ka një të drejtë të zbatuar me ligj për të bërë thyerjen dhe ka për qëllim që ta zgjidh ose në baza neto apo që të realizojë asetin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht.

### **2.8 Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera**

Llogaritë e arkëtueshme tregtare njihen sipas vlerës së tyre reale dhe praktikohet provizioni për dëmtimet në llogaritë e arkëtueshme tregtare për shkak që Ndërmarrja nuk do të jetë në gjendje që të mbledh të gjitha shumat që ia kanë borxh sipas kushteve origjinale të llogarive të arkëtueshme.

### **2.9 Stoqet**

Materialet, pjesët rezervë dhe materiali shpenzues, kryesisht lidhen me hidrocentralin, mirëmbajtjen e kanaleve dhe rrjetit të shpërndarjes së ujit, dhe vlerësohen sipas parimit të çmimit më të ulët ndërmjet kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Kostoja përcaktohet duke përdorur metodën FIFO dhe përfshin shpenzimet e shkaktuara në sigurimin e stoqeve dhe sjelljen e tyre në lokacionin dhe konditat ekzistuese. Vlera neto e realizueshme paraqet çmimin e vlerësuar të shitjes në kursin e zakonshëm të biznesit, minus shpenzimet e aplikueshme variable të shitjes. Materialet dhe pjesët rezervë shpenzohen apo kapitalizohen me impiantet, sipas nevojës, kur të instalohen.



## **2.10 Paratë e gatshme dhe ekuivalentët e parasë së gatshme**

Paratë e gatshme dhe ekuivalentët e parasë së gatshme përfshijnë paratë e gatshme në dorë dhe në bankë. Për qëllime të rrjedhës së parasë paratë e gatshme dhe ekuivalentët e parasë së gatshme paraqesin paratë e gatshme në dorë dhe depozitat në banka me periudhë maturimi prej 12 muaj ose më pak.

## **2.11 Huamarrjet**

Huamarrjet paraqesin kreditë që janë marr nga institucionet financiare dhe qeveritare dhe maten sipas vlerës së tyre reale në kohën e njohjes fillestare dhe pas njohjes fillestare sipas kostos së amortizuar duke përdorur metodën e normës efektive të interesit.

## **2.12 Kontributi shtesë për të punësuarit**

Ndërmarrja duke u bazuar në moshën mesatare të të punësuarve, kontributin e tyre në ndërmarrje, procedurave aktuale të pensionimit, përveç kontributit pensional të obligueshëm sipas legjislacionit në fuqi ka vendosur politika të ndarjes së kontributeve shtesë për të punësuarit. Këto kontribute shtesë i ngarkojnë shpenzimet e pagave në pasqyrat e të ardhurave sipas periudhave kohore kur ndodhin. Që nga muaji Mars 2010, Ndërmarrja ka ndërprerë pagesën e kontributit shtesë për të punësuarit.

## **2.13 Politikat tatimore**

Në bazë të organizimit si ndërmarrje publike me statut të shoqërisë aksionare, ndërmarrja ju nënshtrohet të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi të cilat rregullojnë lëmi të caktuara në të cilat aplikohet tatimi në vlerën e shtuar, kontributet pensionale dhe tatimi në të ardhura personale si dhe sipas Ligjit Nr.03/L-113 për Tatimin në të ardhurat e korporatave, tatimi në të ardhurat e tatueshme të korporatave me normë prej 10% i kalkuluar sipas Deklaratës vjetore të tatimit në fitim.

## **2.14 Njohja e të hyrave**

Të hyrat nga shitja e energjisë elektrike dhe ujit përmbajnë vlerën e faturuar të energjisë elektrike dhe ujit të dorëzuar. Faturimet për shitjet e energjisë elektrike dhe ujit bëhen çdo muaj, me përjashtim të faturimit të ujit për ujitje që faturohet një herë në vit.



## **POLITIKAT E RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT DHE SHPALOSJET (VAZHDIM)**

### **2.15 Grantet**

Grantet nuk njihen derisa të ekzistojë siguri e arsyeshme që Ndërmarrja do të respektojë kushtet e këtyre granteve dhe që ato grante do të pranohen. Grantet kushti kryesor i të cilave është që Ndërmarrja duhet të blejë, ndërtojë ose në ndonjë mënyrë tjetër të sigurojë asete jo-rrjedhëse njihen si të hyra të shtyra në bilancin e gjendjes dhe transferohen në pasqyrën e të ardhurave në bazë sistematike dhe racional përgjatë kohës së përdorimit të aseteve përkatëse.

### **2.16 Politika e rritjes së kontrollit të brendshëm**

Pas transformimit në shoqëri aksionare me qëllim të rritjes së kontrollit të brendshëm, ndërmarrja sipas Ligji për Shoqëritë tregtare (Ligji nr. 02/L-123) dhe Ligjit për ndërmarrjet publike (Ligji nr. 03/ L-087) ka punësuar Zyrtarin për Auditim të Brendshëm.

### **2.17 Zotimet dhe kontingjentet**

Detyrimet kontingjente nuk njihen në pasqyrat financiare. Një detyrim kontingjent shpaloset në të gjitha rastet përveç rasteve kur mundësia e rrjedhës së burimeve që paraqesin përfitime ekonomike është e largët. Një aset kontingjent nuk njihet në pasqyrat financiare por shpaloset kur rrjedhja e përfitimeve ekonomike është e mundur. Shuma e një humbjeje kontingjente njihet si provizion nëse është e besueshme që ngjarjet në të ardhmen do të konfirmojnë që, një detyrim ka ndodhur deri më datën e bilancit të gjendjes dhe se mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes që pason.

### **2.18 Gjykimet kritike në aplikimin e politikave të kontabilitetit të Ndërmarrjes**

Në aplikimin e politikave të kontabilitetit, nga menaxhmenti kërkohet që të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime në lidhje me shumatat e bartura të aseteve dhe detyrimeve të cilat nuk janë lehtësisht të qarta nga burimet tjera. Vlerësimet dhe supozimet e ndërlidhura janë të bazuara në përvojën historike dhe faktorët tjerë të cilët konsiderohen të jenë relevantë. Rezultatet aktuale mund të jenë të ndryshëm nga këto vlerësime.



## 2.19 Burimet kryesore të pasigurisë në vlerësim

Supozimet kryesore në lidhje me të ardhmen, dhe burimet tjera kryesore të pasigurisë në vlerësim në datën e bilancit të gjendjes, të cilat paraqesin një rrezik domethënës për të shkaktuar korigjime materiale në vlerën e bartur të aseteve dhe detyrimeve brenda vitit financiar vijues, janë diskutuar më poshtë: Provizioni për llogaritë e arkëtueshme tregtare: Në rrjedhën normale të biznesit, Ndërmarrja bën vlerësime për kthimin dhe realizimin e llogarive të arkëtueshme. Duke u bazuar në këtë, menaxhmenti regjistron një provizion përkatës për dëmtimin e kërkesave. Rezultatet aktuale mund të jenë të ndryshme nga ato të vlerësuara. Vlerësimi i rasteve ligjore: Në rrjedhën normale të biznesit, Ndërmarrja bën një vlerësim për shumat që nevojiten për shlyerjen e rasteve ligjore sipas udhëzimit të këshilltarit ligjor të Ndërmarrjes. Në bazë të këtij vlerësimi, ndërmarrja në përputhje me këtë regjistron provizionin, nëse ka, apo shpalos detyrimin kontingjent. Rezultatet aktuale mund të jenë të ndryshme nga ato të vlerësuara. Vlerësimi për çështjet ambientale, çaktivizimin dhe çështjet tjera të ndërlidhura Aktualisht nuk ka asnjë kërkesë detyruese ligjore për mjedisin, çaktivizimin dhe dispozitat tjera të lidhura në Kosovë.



### 3. Paraja dhe ekuivalentët e parasë

	<u>Me 31.12.2014</u>	<u>Me 31.12.2013</u>
Depozitat afatshkurtra në banka	0	0
Llogaritë në banka	938,919	1,318,798
Arka	1,929	1,931
Kapitali themeltar	25,000	25,000
<b>Gjithsej:</b>	<b>965,848</b>	<b>1,345,729</b>

### 4. Llogaritë e arkëtueshme

	<u>Me 31.12.2014</u>	<u>Me 31.12.2013</u>
LL. A. nga shitja e Energj. Elek.	356,566	236,209
LL. A. nga shitja e Ujit industrial	355,698	592,025
LL. A. nga Ujitja	273,155	255,717
LL.A. nga interesi	7,283	4,183
Të tjera	0.00	583
<b>Gjithsej</b>	<b>992,702</b>	<b>1,088,717</b>



## 5. Stoqet

	<u>Me 31.12.2014</u>	<u>Me 31.12.2013</u>
Inventari depo Komoran	2,007	1,889
Inventari depo Shkabaj	2,627	3,049
Inventari depo Vushtrri	1,663	1,633
Inventari deo Ujman	2,477	2,477
Inventari depo Shkabaj Teknika	468	468
Materiali në Drejtori	380	380
Materiali depo Komoran	465,726	467,774
Materiali depo Shkabaj	343,737	342,055
Materiali depo Vushtrri	365,495	381,669
Materiali depo Ujman	26,512	26,512
Materiali depo Shkabaj teknika	11,187	11,254
MHT në depo Komoran	862	862
MHT në depo Shkabaj	2,625	1,138
MHT në depo Vushtrri	427	473
MHT në depo Ujman	191	191
<b>Total pjesë reserve dhe material</b>	<b>1,226,356</b>	<b>1,241,738</b>

## Lëvizjet e stoqeve gjatë vitit 2014

Saldo në fillim te vitit:	1,241,738
Blerjet gjatë vitit:	149,824
Shpenzimet gjatë vitit:	(165,207)
<b>Saldo në fund të vitit:</b>	<b>1,226,356</b>



**6. Objektet ndërtimore, makineritë e rënda dhe pajisjet**

	<b>Objektet ndërtimore</b>	<b>Makineritë e renda</b>	<b>Pajisjet dhe inventari</b>	<b>Inv. ne vijim</b>	<b>Total</b>
<b>(në EUR)</b>	<b>(në EUR)</b>	<b>(në EUR)</b>	<b>(në EUR)</b>	<b>(në EUR)</b>	<b>(në EUR)</b>

**KOSTO/KOSTOJA E VLERËSUAR**

<b>Ië 01 Janar 2013</b>	<b>275,440,798</b>	<b>4,151,110</b>	<b>7,589,708</b>		<b>287,181,616</b>
Shtesat gjatë vitit	1,049,662		179,594		1,229,256
Investimet e aktivizuara	878,805				878,805
hitja, çregjistrimi gjatë vitit			-24,509		-24,509
<b>Më 31 Dhjetor 2013</b>	<b>277,369,265</b>	<b>4,151,110</b>	<b>7,744,793</b>		<b>289,265,167</b>
<b>Më 1 Janar 2014</b>	<b>277,369,265</b>	<b>4,151,110</b>	<b>7,744,793</b>		<b>289,265,167</b>
Shtesat gjatë vitit	851,573		23,520		875,093,330
Investimet e aktivizuara					
hitja, çregjistrimi gjatë vitit			-11,151		-11,151
<b>Më 31 Dhjetor 2014</b>	<b>278,220,838</b>	<b>4,151,110</b>	<b>7,757,162</b>		<b>290,129,110</b>
<b>Zhvlerësimi i akumuluar</b>					
<b>Të 1 Janar 2013</b>	<b>145,128,195</b>	<b>2,490,665</b>	<b>7,044,670</b>		<b>154,663,530</b>
Amortizimi i vitit 2014	4,401,973	83,022	128,486		4,613,481
Shitja, çregjistrimi gjatë vitit					
Amortizimi ME 31.12.2014	(149,530,168)	(2,573,687)	(7,173,156)		(159,277,011)
<b>VLERA NETO E ASETVEVE ME 1.12.2014</b>	<b>128,690,670</b>	<b>1,577,423</b>	<b>584,006</b>		<b>130,852,099</b>
<b>VLERA NETO E ASETVEVE ME 1.12.2013</b>	<b>132,241,070</b>	<b>1,660,445</b>	<b>700,123</b>		<b>134,601,637</b>



Gjate vitit 2014 ndërmarrja ka bërë investime në objekte ndërtimore në vlerë prej 851,573.01 Euro dhe në pajisje në vlerë prej 23,520.30 Euro.

Me datën 31.12.2014 nuk ka zëra të pronës, objekteve, makinerive dhe pajisjeve të lëna peng si ndonjë garancion për ndonjë detyrim.

Çregjistrimi i mjeteve dhe pajisjeve:

	Vlera blerëse:	Zhvlersimi.i akumuluar	Vlera sipas librave
Paisjet	11,151.26	10,925.89	225.37
<b>Totali</b>	<b>11,151.26</b>	<b>10,925.89</b>	<b>225.37</b>

Mbështetur në SNK-12-Tatimet mbi të ardhurat, paragraf.15, 20 ,29 , 31,35 dhe 82, me qenë se zhvlerësimi vjetorë është shumë i lartë dhe tejkalon të hyrat e gjeneruara gjatë vitit për këtë shkak ndërmarrja disa vite operon me humbje pas zhvlerësimit, në pamundësi të gjenerimit të fitimit të tatueshëm ndërmarrja nuk ka njohur në pasqyrat e veta ndonjë pasuri apo detyrim të shtyrë tatimor për vitin 2014.

## 7. Detyrimet afatshkurtëra

### 7.1.Llogaritë e pagueshme

	<u>Me 31.12.2014</u>	<u>Me 31.12.2013</u>
KEK- Dispeqing Mitrovica	18,190	19,836
KEK- Dispeqing Prishtina	5,543	6,445
PTK -Prishtinë	706	769
KUR Mitrovica	5	
KUR Batllava	460	157
Furnitor tjerë	469,219	439,468
<b>Gjithsejt llogaritë e pagueshme</b>	<b>494,123</b>	<b>466,675</b>



## 7.2.Detyrime tjera afatshkurtëra

	<u>Me 31.12.2014</u>	<u>Me 31.12.2013</u>
Tatimi në paga	35,113	29,136
Detyrime tjera afatshkurtëra (TVSH, Kontribute, tatim në interes,)	69,776	235,079
<b>Gjithsejtë:</b>	<b>104,889</b>	<b>264,215</b>
<b>8. Gjithsejtë Detyrime tjera afatshkurtra</b>	<b>599,012</b>	<b>730,890</b>

## 8. Detyrimet afatgjata-grantet

	<u>Me 31.12.2014</u>	<u>Me 31.12.2013</u>
Të hyrat e shtyra	479,434	485,156
Huaja afatgjate	0.00	0.00
<b>Gjithsej detyrimet afatgjata:</b>	<b>479,434</b>	<b>485,156</b>

Grantet janë në vlerë prej 479,434 Euro te cilat janë pajisje dhe stoqe (material).

Emërtimi	Gjendja 2013	Grantet 2014	Shpenzimet 2014	Gjithsejtë
Pajisje – mjete themelore:	242,353	0.00	5,102	237,251
Materiali	242,138	0.00	510	241,628
Të hyrat e shtyra nga ujitja	665	0.00	0.00	555
<b>Gjithsejtë grantet</b>				<b>479,434</b>

Grantet ne pajisje janë të përfshira në pasqyrën e të ardhurave si detyrime jo qarkulluese të regjistruara si të hyra të shtyra aq sa është zhvlerësimi i tyre për periudhën sipas metodës lineare të alokuar në kostot për gjatë jetës së përdorimit të tyre.

Grantet në materiale te regjistruara si stoqe janë të paraqitura në pasqyrën e të ardhurave si të hyra të shtyera në momentin e shpenzimit sipas koston së tyre.



**9. Të hyrat**

<b>Të hyrat</b>	<b><u>Me 31.12.2014</u></b>	<b><u>Me 31.12.2013</u></b>
Të hyrat nga Energj. Elek.	2,583,785	2,517,949
Të hyrat nga Uji industr.	1,389,590	1,348,268
Të hyrat nga Ujitja	169,497	191,676
<b>Gjithsej:</b>	<b>4,142,873</b>	<b>4,057,893</b>

**10. Të hyrat tjera**

Te hyrat e tjera (Interesi, grantet, rimbursimet)	46,603	111,988
<b>Gjithsejt të hyrat</b>	<b>4,189,476</b>	<b>4,169,881</b>

**11. Pagat**

<b>Pagat</b>	<b><u>Me 31.12.2014</u></b>	<b><u>Me 31.12.2013</u></b>
Pagat bruto	2,800,167	2,698,938
<b>Pagat bruto</b>	<b>2,800,167</b>	<b>2,698,938</b>



**12. Shpenzimet operative**

	<u>Me 31.12.2014</u>	<u>Me 31.12.2013</u>
Shpenz. e mirëmbajtjes dhe riparime	33,348	44,112
Shpenz. Administrative	91,059	68,874
Shpenz. e energj. elektrike	345,807	276,066
Shpenz. e derivateve	62,572	59,190
Shpenz. per sherbime	50,763	55,830
Shpenz. e mallerave dhe materialit	104,181	75,106
Shpenz. per material hargjues dhe taksa	184,855	194,247
<b>Gjithsej shpenzimet operative</b>	<b>872,585</b>	<b>773,425</b>



### **Fushëveprimi- Objektivat dhe shtrirja e auditimit**

Auditimi është përformuar në harmoni me SNA. Standardet e përmendura kërkojnë që ne të planifikojmë dhe ekzekutojmë auditimin në mënyrë që të nxjerrët një siguri e arsyeshme se gjendjet e prezantuara në Pasqyrat Financiare nuk kanë pasur keqpohime materiale apo ndryshime. Auditimi jonë përmbanë hulumtimin e informatave të mbledhura të rëndomta për të vërtetuar shumat dhe informatat e prezantuara në raportin financiar. Po ashtu përmban hulumtimin dhe mendimin mbi politikat e kontabilitetit të cilat janë aplikuar, duke i dhënë rëndësi të veçantë, se si janë bërë ato nga menaxhmenti, dhe hulumtimi mbi prezantimin gjeneral të kontove të shoqërisë.

### **Sigurimi i dëshmive dhe testeve gjatë procesit të Auditimit**

Në NH Ibër Lepenc SH.A. kemi kryer një sërë testesh përmes mostrave të dëshmive autentike. Punën e testimit dhe sigurimit të dëshmive kryesisht e kemi zhvilluar me ndihmën e stafit të entitetit të cilët kanë treguar nivel të lartë të bashkëpunimit.